VOLUMI V Nr. 3, 30 SHTATOR 2009,
INSTITUTI I STUDIMEVE NDERKOMBETARE (AIIS)
TEL. +355 4 224 88 53 EMAIL: aiis@aiis-albania.org

# EUROPA

KRYEREDAKTOR: MARSIDA GJONÇAJ • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JASHTE: ADELA HALO

# Zgjedhjet e qershorit shënuan progres




Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009 shënuan një progres të prekshëm për sa i përket regjistrimit të votuesve dhe procesit të identifikimit, kuadrit ligjor të miratuar në mënyrë konsensuale nga dy partitë kryesore në vend, për sa i përket votimit, numërimit dhe gjykimit të konflikteve zgjedhore. Këto përmirësime të konsiderueshme u zbehën nga politizimi i aspekteve teknike të procesit lidhur me numërimin e votave dhe hartimin e tabelave të rezultateve, gjë që përkohësisht bllokoi procesin e numërimit në disa zona, si edhe nga shkeljet e vëna re gjatë fushatës zgjedhore. Këto veprime të partive politike lëkundën besimin e publikut në procesin zgjedhor.

Edhe pse përmbushën shumicën e angazhimeve ndaj OSBE-së, këto zgjedhje nuk realizuan plotësisht potencialin e Shqipërisë për t'iu përmbajtur standardeve më të larta për zgjedhje demokratike. Zhvillimi i zgjedhjeve demokratike varet gjithashtu, në një masë të madhe, nga angazhimi i të gjitha partive politike shqiptare për të respektuar ligjin dhe qëllimin e tij në detajin më të vogël, si dhe për t'i përmbushur detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme me synim ruajtjen e integritetit të procesit. Zgjedhjet u zhvilluan sipas një Kodi të ri Zgjedhor Edhe pse përmbushën shumicën e angazhimeve ndaj OSBE-së, këto zgjedhje nuk realizuan plotësisht potencialin e Shqipërisë për t'iu përmbajtur standardeve më të larta për zgjedhje demokratike. Zhvillimi i zgjedhjeve demokratike varet gjithashtu, në një masë të madhe, nga angazhimi i të gjitha partive politike shqiptare për të respektuar ligjin dhe qëllimin e tij në detajin më të vogël, si dhe për t'i përmbushur detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme me...

FAQE 7

## Në këtë numër:

Banka Boterore: Maqedonia midis dhjetë reformuesve FAQE 4
Rainer Stinner: Ballkani në BE si rajon i tërë FAQE 5
Komisioni Europian: Hapa pozitivë drejt lëvizjes së lirë FAQE 9
Traktati mbi Bashkimin Evropian FAQE 14

ME MBESHTETJEN E FONDACIONIT SHOQERIA E HAPUR PER SHQIPERINE (FONDACIONI SOROS, OSFA)

CMYK